



Muhamed Sytari

Islamofobia e shfaqur gjatë këtyre ditëve nga disa klerikë, shkrimtarë, analistë, deputetë e gazetarë, pas vizitës së kryeministrit të Turqisë në Kosovë dhe tundimi qesharak për t'u bërë protagonist me një deklaratë a një intervistë i shumë personazheve me fytyra të ngrysur, në të vërtetë është një sinjal jo i mirë, që vërteton se në gjendje të tilla krize dhe tranzicioni shpirtëror, intelektual e identitar, mllefi dhe urrjetja fetare është në gjendje të prishë e të shkatërrojë vlerat e harmonisë ndërfaqetare në trojet shqiptare, nëse fytyrë-ngrysurit mund të kenë pushtet e influencë në një shoqëri të çoroditur e të hutuar nga daullet e shumta që bien sa djathtas-majtas.

Kemi dëgjuar gjatë këtyre ditëve deklarata e intervista, kemi lexuar shkrime e analiza, që në të vërtetë janë një grumbull i madh vneri, i fëlliqtë në vetëvete, por sinjalizues i një fryme të harruar mesjetare, që vriste e poshtëronte në emër të mllefrit e urrejtjes ndaj kundërshtuesve të saj!

Ky realitet i krijuar vërtetoi më së miri se ISLAMI mbetet përherë rrezatues për pasuesit e tij, një shtyllë e fortë e mbrojtjes dhe kultivimit të vlerave kombëtare shqiptare, si dhe një kala mirësie hyjnore për shqiptarët, e padepërtueshme nga shigjetat e helmuara të misionarëve të mesjetës bashkëkohore, me rrobë të re e pamje sipas shijeve perëndimore!

FRIKË! Ky është përkufizimi më i mirë për të gjithë të strukurit në realitetet e zymta të gjirizeve mesjetare, që përpiqen dita-ditës ta hedhin shqiptarin greminave të zhveshjes nga identiteti i tij besimor, traditat e gjyshërve, tabani i familjes dhe qytetaria e fisme, në emër të heronjve legjendarë, miteve qesharake, përrallës së lirisë së mendimit dhe demokracisë laike, "pushtuesit shkatërrimtar që na ndryshoi fenë me dhunë" etj, etj pa fund.

Çfarë vlere intelektuale mund të ketë një deklaratë injorante e një deputeti hibrid, pa asnjë shkallë dije a ngjyresë intelektuale, kur përmend mënyrën sesi shqiptarët e kanë pranuar

Islamin, apo neo-otomanizmin në një deklaratë mjerane?

Çfarë kuptimi ka deklarata e një kleriku, përfaqësues i një komuniteti të vogël minoritar, kur hedh shashka vneri, që në një mënyrë a një tjetër prekin ndjenjat dhe shpirtin e muslimanëve, që me dashamirësi e kanë pranuar në mes vete, duke i hapur dyert e duke bashkëjetuar si vëllezër gjaku, gjuhe, kulture e traditash ndër shekuj?!

Çfarë kuptimi ka që të vazhdojmë e të dëgjojmë misionarë laramanë, që na përmendin ditë pas dite Islamin, si kancer në genin tonë kombëtar, si pengues të integritetit në "kontinentin e vjetër katolik" e sa e sa broçkulla pa kripë, që u ka perënduar dielli me kohë?!

Këtu, më vjen ndër mend historia e të parëve të mi muslimanë dhe toleranca e tyre ndaj "tjetrit", kushdo që të ishte ai. Më vjen ndër mend sesi muslimanët shkodranë kanë strehuar hebrenjtë, për t'i shpëtuar nga vdekja e sigurt në duart e një pushtuesi (aq sa hise mund të kishte ai në këtë fjalë). Më dalin para syve qëndrime të shquara të burrave të urtë muslimanë shkodranë, në nder të vëllezërve të tyre të gjakut e gjuhës, katolikë e ortodoksë. Ne muslimanët nuk jemi si ky takam injorant, që hidhet si i shastisur për të prishur gjakun, shekujt, traditat e identitetin, vetëm e vetëm se ka lidhur një besë për një histori të perënduar!? **NE NUK JEMI KËSHTU!**

Por, të dëgjosh e të bëhesh dëshmitar i kësaj fryme të lajthitur e hysterike të disa njerëzve të pa vlerë, vetëm e vetëm se kanë pranuar të jenë misionarë të smogut mesjetar, kjo është e patolerueshme!

Prandaj, islamofobëve të qytetit tim, islamofobëve shqipfolës, mbarë islamofobëve, të shfaqur e të heshtur, u them ashtu si në Kur'an u thuhet modeleve të tyre në kohëra të lashta: "Thuaju: "Vdisni me mllefin tuajin!" - (Kur'an, Ali Imran, 119).

Sepse islamofobia është GUR i rëndë që ngushton gjokset e sëmura të njerëzve që janë mësuar të thithin kolerë mesjete, në vend të ajrit të pastër nga burimi i tij!

Ne muslimanët e kemi të shenjuar rrugën tonë prej shekujsh, nuk na lëkund histeria e dikujt, as laramanizmi i dikujt tjetër, as tendenca injorante e të bërit protagonist me simbolet e Islamit në gojën e dikujt tjetër! Por, nuk do të heshtim, sepse heshtja në disa raste është e gabuar!

Autori është Myfti i Zonës Shkodër.